



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije- Ministry of Trade and Industry

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

Me qëllim të promovimit të kompanive prodhuese kosovare në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), shpallë:

Ftesë për shprehje të interesimit për pjesëmarrje në stendën e përbashkët të Kosovës, në Panairin “ANUGA”, 07-11 tetor 2017 në Këlln (Koln), Gjermani.

Kosova edhe këtë vit do të marrë pjesë me stendë të përbashkët në panairin më të madh të ushqimit dhe pijeve në botë, i cili do të mbahet në Këlln (Koln) të Gjermanisë në datat 07-11 tetor 2017.

Hapësira ekspozuese dhe brendimi i saj do të organizohet nga KIESA. Mbështetja financiare do të mbulojë shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin dhe dizajnin e shtandit, regjistrimin e kompanive, shpenzimet për rrymë, pastrim ditor etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe dërgimin e produkteve do të merren përsipër nga kompanitë pjesëmarrëse.

Ju lutem vini re se vetëm shprehjet e interesimit të dërguara deri me datë 31.05.2017 dhe vetëm pyetësorët e plotësuar tërësisht mund të konsiderohen për vlerësim.

Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (në sallën e konferencave në KIESA) më 29 maj, në ora 14:00, ekspertët e KIESA-s do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe për mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Kompanitë që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Aplikimi: Kompanitë që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar pyetësorin dhe ta dërgojnë atë më së largu deri më 31.05.2017 në e-mail adresën info.kiesa@rks-gov.net ose në Ministria e Tregtisë dhe Industrisë/KIESA, Rruga: Muharrem Fejza, Lagja e Spitalit, p.n. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë/KIESA, dhe mund të shkarkohen nga ueb faqet: <http://mti.rks-gov.net/> ose <http://kiesa.rks-gov.net> ose në postën elektronike info.kiesa@rks-gov.net